



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0970

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi dhe Batisha Ibrahimimi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik OE “PATRONI” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Lëndë Djegëse për Kaldajë – Mazut(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a., më 11/12/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “PATRONI” SH.P.K. me nr. 2024/0970, e datës 10/10/2024, kurse vendimi i AK “KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVES” sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1, anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues- “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a. të zbatojë vendimin e OSHP-së me numër: PSh. nr.2024/0513 i datës 19.08.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1.
3. URDHËROHET Autoriteti Kontraktues- “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a., që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së: PSh.nr.2024/0513 i datës 19.08.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1.
4. Mos respektimi i kësaj urdhërese në afat prej pesë ditësh kalendarike do ta detyrojë Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe në të njëjtën kohë të kërkojë nga KRPP, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së /Komuna e Drenasit, konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

5. Lejohet ti kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i deponitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 18.01.2024, “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Lëndë Djegëse për Kaldajë – Mazut(Fuel Oil 1.0%)” me nr. të prokurimit: KEK-24-186-1-1-1. Ndërkaq me datën 23.09.2024 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK me të cilin ka shpërblyer me kontratë OE “EX FIS”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 6,650,000.00 €.

Me 27.09.2024, OE “PATRONI” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 02.10.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10/10/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “PATRONI” SH.P.K., me nr. 2024/0970 lidhur me aktivitetin “Furnizim me Lëndë Djegëse për Kaldajë - Mazut(Fuel Oil 1.0%)” me numër të prokurimit KEK-24-186-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "PATRONI" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Fillimisht Njoftimi mbi vendimin e AK-së ishte bërë me dt.25.03.2024 ku ishte rekomanduar për kontratë OE Ex Fis SI-IPK me çmim prej; 109.00 € dhe total prej:6,381.572.14 €.

Neve kishim pranuar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Pastaj, me dt.02.04.2024 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Kërkesa për rishqyrtim ishte aprovuar dhe lënda ishte kthyer në rishqyrtim.

Prej datës së aprovimit të kërkesës për rishqyrtim, pra prej dt.05.04.2024, deri me dt. 22.05.2024 nuk ishte kryer rivlerësimi dhe rishqyrtimi, ku çështja e vetme që ishte rishqyrtuar ka qenë nënshkrimi i deklaratës për afat të liferimit dhe paramasës dhe përshkrimi i çmimeve pa autorizim.

Më pastaj ishte publikuar njoftimi mbi vendimin me dt. 22.05.2024, ku përsëri ishte rekomanduar për kontratë i njëjti operator ekonomik.

Pas kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës në OSHP është nxjerr vendimi panelit shqyrtues dt.19.08.2024 Nr.2024/0513, ku ishte aprovuar ankesa si e bazuar ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ishte shpallur i papërgjegjshëm.

Më poshtë po citojmë konstatimet e panelit shqyrtues ën lidhje me nënshkrimet e kontestuar.

Paneli shqyrtues konkretisht ka vërejtur se nënshkrimet tek deklaratata në betim .deklarata për specifike teknik dhe deklarate e prodhuesit janë të Drejtorit Lum Muharrem kurse tek deklarata për afat të liferimit dhe nënshkrim tek paramasa me përshkrim të çmimit nuk janë idemike me nënshkrimin e Drejtorit. pra ndryshojnë dhe ka mos përputhje të nënshkrimeve tek dokumentet e prezantuara në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Sa i përket nënshkrimeve të vendosura te dy dokumentet e kontestuar përkatësisht tek deklaratat

për afat të liferimit dhe tek paramasa me përshkrim të çmimit, paneli shqyrtues ka analizuar këto dy nënshkrime dhe ka ardhur në përfundim se autoriteti kontraktues e as eksperti shqyrtues nuk kanë dëshmuar se nënshkrimet e vendosura në këto dy dokumente janë të personit për të cilin pretendon OE i rekomanduar për kontratë dhe për të cilin ka bashkëngjitur një autorizim me rastin e sqarimeve shtesë.

Madje eksperti shqyrtues edhe në seancën dëgjimore të dt.14.08.2024 nuk ka marrë përgjegjësinë se janë vërtetuar nënshkrimet e këtyre dy dokumenteve dhe nuk ka marrë përgjegjësinë se këto dy nënshkrime janë të personit, për të cilin OE i rekomanduar për kontratë ka bashkëngjitur autorizimin me sqarime shtesë.

Për më tepër gjatë analizës së nënshkrimeve të këtyre dy dokumenteve, paneli shqyrtues ka vërejtur se nënshkrimet në këto dy dokumente nuk janë të vendosura në formatin dhe mënyrën e njëjtë, pasi që tek paramasa me përshkrimin të çmimit, tek rubrika e nënshkrimit është shënuar fjala ‘për’* dhe është vendosur nënshkrimi i cili nuk është vërtetuar as nga autoriteti kontraktues e as nga eksperti shqyrtues se i cili person është.

Ndërsa tek deklaratat për afat të liferimit tek rubrika e nënshkrimit është vendosur nënshkrimi i njëjtë sikurse tek paramasa me përshkrim të çmimit, mirëpo në këtë rubrikë e as në rubrikat tjera nuk është vendosur fjala "për" dhe kjo për panelin shqyrtues dëshmon pa rregullsi të nënshkrimit të këtyre dokumenteve përkatësisht mënyrës së nënshkrimit të këtyre dokumenteve dhe dëshmon pamundësi të vërtetimit nga ana e AK dhe e ekspertit shqyrtues të këtyre nënshkrimeve.

Për më shumë në lidhje me autorizimet për nënshkrim të dokumenteve të tenderit . KRPP ka interpretuar një opinion një dt. 24.10.2023 tek pyetjet e shpeshta përkatësisht pyetja me nr.14, ka sqaruar se domosdoshmërisht për të nënshkruar dokumentet e tenderit një person tjetër duhet të jetë i autorizuar për këtë qëllim. ndërsa në rastin konkret nuk është dëshmuar dhe vërtetuar nga autoriteti kontraktues e as nga eksperti shqyrtues se nënshkrimi i dy dokumenteve është i personit të autorizuar. prandaj ky fakt për panelin shqyrtues dëshmon papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë, Dhe nevojën që AK të veprojë konform nenit 52.7 të LPP.

Nga konstatimet e lartcekura tek vendimi i OSHP-së kuptohet se AK-së ka vepruar në kundërshtim me vendimin e panelit shqyrtues të dt.19.08.2024 Nr.2024/0513 dhe me këtë rast është vepruar edhe në kundërshtim me nenin 97.1 pika (h) të Rregullores nr.001/2022

Për Prokurim Publik pasi që ky veprim përbën shkelje të rëndë. Ky veprim sanksionohet me revokim të certifikatës së prokurimit për ZPP siç parashihet në nenin 99 të RRPP Nr.0012022.

- Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me dt. 23.09.2024, duke mos u respektuar vendimi i panelit shqyrtues, ndërsa ne me dt.25.09.2024 kemi kërkuar qasje në dokumente ku me dt.26.09.2024 na është lejuar qasja, ku kemi vërejtur se AK-së me dt. 13.09.2024 është kërkuar sqarime përsëri nga OE i rekomanduar për kontratë ExFis, kurse i njëjti ka dhënë përgjigje me dt. 16.09.2024 duke thënë se nënshkrimi nëpër dokumentet e kontestuar është i Fatbardh Muharremi.

Edhe me këto sqarime nuk është bashkangjitur ndonjë dëshmi tjetër shtesë për të konfirmuar nënshkrimet e kontestuara por vetëm është bashkangjitur edhe njëherë autorizimi i cili ishte bashkangjitur edhe në sqarimet e mëhershme. Pra nuk ka asnjë dëshmi tjetër shtesë dhe konkrete për të vërtetuar nënshkrimet e kontestuara por vetëm pohime dhe fjalë.

Realisht nuk ka pasur arsye të kërkohej sqarime në lidhje me këtë çështje sepse edhe me sqarimet e dt. 17.05.2024 nuk ishin konfirmuar dhe vërtetuar se nënshkrimet e deklaratës mbi afatin e liferimit dhe nënshkrimin e paramasës ishin të Fatbardh Muharremi, dhe se me vendimin e OSHP-së Nr.2024/0513 OE i rekomanduar për kontratë ishte deklaruar i papërgjegjshëm.

Më poshtë janë të përsëritura edhe njëherë sikurse në herën e kaluar pretendimet tona ankimore në lidhje me OE e rekomanduar përkontratë. AK-së me dt. 17.05.2024 ka kërkuar sqarim nga OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me nënshkrimin e deklaratës mbi afatin e liferimit dhe nënshkrimin e paramasës.

Nga këto dokumente, kemi vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë përgjigje me dt. 17,05.2024 ku ka theksuar se personi i cili ka nënshkruar këto dokumente është z. Fatbardh Muharremi i lindur me 02.11.1978 dhe numër te ID. 1004811905, i cili është përfaqësues i autorizuar i kompanisë tone EXFIS shpk.

Me këtë përgjigje është bashkangjitur edhe një autorizim i përgjithshëm i dt. 14.01.2022 për Fatbardh Muharremi i lëshuar nga Drejtori Menaxhues Lum Muharremi, i cili autorizim figuron se është noterizuar tek Noter Learte F. Cena.

Ne edhe në kërkesën për rishqyrtim të dt.02.04.2024 kemi pas pretendim se deklarata nën betim, deklarata për specifikime teknike, deklarata për prodhuesit janë të nënshkruara në emër të Lum Muharremi që figuron Drejtor, ndërsa deklarata për afat të liferimit dhe paramasa dhe përshkrimi

i çmimeve janë të nënshkruara nga dikush tjetër e jo nga Drejtori.

Pra edhe me sqarimet e dt.17.05.2024 e edhe me sqarimet e dt.16.09.2024 janë bashkëngjit dëshmitë e njëjta përkatësisht autorizimi i njëjtë dhe pothuajse janë përshkruar fjalët e njëjta nga OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo absolutisht nuk është bashkëngjitur asnjë dëshmi tjetër konkrete për të dëshmuar të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Pasi që edhe tani janë ofruar dëshmitë njëjta, atëherë rezulton se edhe këto dëshmi janë në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit pasi që vendimi i panelit shqyrtues Nr.2024/0513 kishte konstatuar papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë, prandaj kërkesa për sqarime ka qenë e kundërligjshme dhe e panevojshme sepse paneli shqyrtues ka sqaruar dhe ka konstatuar drejtë çështjen e këtyre dokumenteve.

Sa i përket Autorizimit konsiderojmë se është çështje e gjykuar/Res Judicata ky rast sipas nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP-së, ku aty ceket si në vijim: Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.

Mos respektimi i vendimit të OSHP-së bënë pjesë në shkelje të rënda sipas nenit 97.1 pika (h) të RRPP Nr.001/2022.

Sa i përket autorizimit të prezantuar me sqarime, sqarojmë se ky autorizim nuk mund të merret parasysh dhe nuk është valid sepse në njërën anë shkruan autorizim gjeneral, ndërsa në brendi janë cek rastet kur mund të përfaqësoje dhe nënshkruar në emër të drejtorit Lum Muharremi.

Në brendi të këtij autorizimi, askund nuk shkruan se i njëjti ka të drejtë të nënshkruaj në emër të drejtorit dokumentet të tenderit apo deklaratë për liferim të mallit apo paramasën dhe përshkrimin e çmimeve.

Përveç këtij fakti, nënshkrimi nëpër deklaratë që ne i kemi kontestuar nuk dihet se i cilit person është.

Më poshtë shihen nënshkrimet tek deklaratë per afat të liferimit.

Ky nënshkrim nuk është valid, sepse ekziston vetëm një nënshkrim dhe nuk dihet se i kujt është ky nënshkrim. Siç shihet nënshkrimi nuk është bërë në emër të drejtorit, pra nuk është nënshkruar për Lum Muharremi, prandaj ky nënshkrim është i parregullt dhe jo valid.

Me poshtë është paramasa me përshkrim të çmimit, ku shihet që tek nënshkrimi sliksuan “për” dhe nuk dihet se përkënd flitet në këtë rast. Ky nënshkrim nuk është i vlefshëm sepse nuk kemi nënshkrim valid nga personat kompetent.

Edhe në këtë dokument nuk kemi nënshkrim për Lum Muharremi, i cili është drejtor, por tek ky dokument tek rubrika nënshkrimi shënohet “për”, ndërsa është një nënshkrim që nuk dihet i kujt është dhe për kënd është nënshkruar. Në këtë rast, tek rubrika nënshkrimi vetëm është shënuar për. Në secilin variant, në këtë rast nuk kemi nënshkrim të rregullt dhe valid. Në asnjërin dokument nuk është nënshkruar Për drejtorin dhe po ashtu nuk dihet se i kujt është nënshkrimi. Madje tek përshkrimi i çmimit po i bëjë se për dikend tjetër po nënshkruan dikush tjetër. Pra jo Për Lum Muharremin, por për një person tjetër po nënshkruan dikush tjetër.

Duke pasur parasysh këto sqarime dhe dëshmi, rezulton se autorizimi i bashkangjitur me sqarime nuk mund të merret parasysh, sepse askund nuk vërtetohet se i njëjti person ka nënshkruar këto dokumente, pasi që të njëri dokument është vetëm një nënshkrim, kurse tek tjetri ekziston fjala “PËR” dhe është një nënshkrim, e që nuk dihet se i kujt është nënshkrimi dhe në emër të kujt po nënshkruhet.

Duke pasur parasysh këto dëshmi konkrete, rezulton se oferta e OE të rekomanduar për kontratë administrativisht është e papërgjegjshme, pasi që këtë çështje e ka sqaruar edhe KRPP tek pyetja (pyetjet e shpeshhta) nr.I4 e dt.24.10.2023.

Pra, edhe me sqarime shtesë nuk janë ofruar dëshmi konkrete dhe bindëse se dokumentet janë në rregull dhe se janë nënshkruar nga personat kompetent, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga konkurrenca.

2. Përveç kësaj, OE i rekomanduar në kontratë ka ofertuar me çmime i normalisht të ulëta dhe me çmime që nuk mund ta përmbush kontratën.

Siç shihet tek përshkrimi i çmimeve, OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim total dhe shpenzime doganore prej 109.00 6 dhe çmim total prej:6,381.572.14 €, e që rezulton se nuk mund ta përmbush kontratën me këto çmime.

Me këtë çmim të ofruar, OE i rekomanduar për kontratë jo që nuk ka fitim në këtë tender por nuk mund ta sjell deri tek KEK mazutin.

Më poshtë po ua bashkëngjisim tri oferta të furnizuesve të ndryshëm, e që këta furnizues i ka cekur edhe vetë OE i rekomanduar për kontratë.

1. Prodhuesi Lotus OIL Builgari:

2. Prodhuesi PETROLEUN SA-Hellenic Greqi:

3. Prodhuesi SllovaNafti Sllovaki

Siç shihet nga sqarimet dhe dëshmitë të cilat i bashkëngjitëm në këtë kërkesë për rishqyrtim kuptohet qartë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është me çmim jo normalisht të ulët, madje çmimet e vendosura në ofertë janë çmime imagjinare e që nuk kanë asnjë mbështetje te ndonjë prodhues/furnizues.

Për më tepër, ky fakt mund të vërtetohet nëse komunikohet me prodhuesit për të vërtetuar pretendimin tonë ankimor në lidhje me ofertat e tyre. Prandaj e inkurajojmë edhe ekspertin shqyrtues që të vërtetojë këtë pretendim.

Ne kemi kërkuar edhe në kërkesën për rishqyrtim të dt.02.04.2024 që AK-ja ti drejtohet prodhuesve, mirëpo nuk jemi në dijeni që është ndërmarr një veprim i tillë nga ana e tyre. Autoriteti kontraktues është dashur ti analizojë çmimet e OE të rekomanduar për kontratë dhe eventualisht të kërkojë sqarime se a mund ta implementojë këtë kontratë OE i rekomanduar për kontratë, e jo automatikisht ta shpall fitues pa një analizë të saktë të çmimeve.

Ne me dt.02.10.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku autoriteti kontraktues e ka cekur se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që vendimin e saj nuk e ka arsyetuar fare.

Në lidhje me autorizimin ka pretenduar se ka vepruar sipas nenit 52.7 të LPP-së dhe nenit 38.3 të RRPP, mirëpo këto sqarime janë të njëjta me kërkesën e kaluar dhe nuk ka asnjë risi, prandaj ky pretendim i AK-së më tepër është mbulesë për shkeljet e tyre ligjore që i kanë bërë në këtë tender.

Autoriteti kontraktues në mungesë të argumenteve për të kundërshtuar pretendimet tona ankimore, vetëm ka sqaruar se ka kërkuar sqarime dhe pas pranimit të dokumenteve/autorizimit ka marr vendim. kjo përgjigje nuk ka të bëjë fare me realitetin dhe me dëshmitë që janë prezantuar, prandaj në mungesë të argumenteve të AK-së, konsiderojmë se edhe vetë AK-së në mënyrë implicite ka pranuar përgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë.

Pra, autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së dhe neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse oferta e OE të rekomanduar është dashur të konsiderohet ofertë me çmim jo normalisht të ulët.

Në këtë rast nuk është respektuar edhe neni 41 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik sepse fillimisht AK-së nuk ka kërkuar sqarime dhe se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arsyetuar se si mund ta realizojë kontratën me këtë çmim.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 të LPP-së, ku Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojnë në mënyrë transparente.

Po ashtu neni 7 paragrafi 6 pika (vi) e LPP-se ceket „që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet për mbajtjesorë të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse¹¹, ndërsa në këtë rast oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk përputhet me të gjitha kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit,

Po ashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë nga OSHP që konform nenit 131 të LPP-së të shqiptojë gjobë autoritetit kontraktues për mos respektim të vendimeve të OSHP-së Nr.2024/513 i dt.19.08.2024, dhe njëkohësisht kërkojmë që të kërkon nga KRPP që ti revokohet licenca ZPP për shkelje e rënda që i ka bërë me rastin e mosrespektimeve të vendimeve të OSHP-së, pra që KRPP të veprojë konform nenit 99 të RRPP Nr.001/2022, sepse veprimet e AK-së janë në kundërshtim me nenin 97 të rregullores së lartpërmendur.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “PATRONI” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1, 7, 52, 59, 60, 61, 69, dhe 72 të LPP-së Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, Neni 97 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, Vendimi panelit shqyrtues dt.19.08.2024 Nr.2024/0513 . Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet te cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të nxjerr: VENDIM TE APROVOHET, e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE PATRONI SH.P.K. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Detyrohet AK-së të respektojë vendimin e OSHP-së Nr.2024/0513 të dt.19.08.2024.

Përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim. AK ka vlerësuar dhe shqyrtuar me kujdes pretendimin nr. 1, mbi çështjen e nënshkrimeve të vendosura në Deklaratën për afat të furnizimit/liferimit dhe në Paramasën me përshkrim të çmimit, të dorëzuar nga OE EX FIS SHPK dhe pas analizës së hollësishme të këtij pretendimi ka konkluduar se i njëjti është i pabazuar për arsyet në vijim.

Më datë 13.09.2024, AK, duke vepruar konform nenit 52.7 të LPP dhe nenit 38.3 të RRPP, ka kërkuar nga OE EX FIS SHPK sqarime lidhur me çështjet e ngritura në vendimin OSHP. Nr. 2024/0513, dt. 19.08.2024. të cilat përshkruhen edhe në pikën nr. 1 të Kërkesës tuaj për rishqyrtim.

Pas pranimit të përgjigjes së OE EX FIS SHPK në kërkesën për sqarime, dt. 16.09.2024, si dhe dokumenteve shoqëruese të bashkëngjitura, AK ka vërtetuar faktet e mëposhtme vendimtare, më saktësisht ka vërtetuar se:

Nënshkrimet kaligrafike në Deklaratën për afat të furnizimit/liferimit dhe në Paramasën me përshkrim të çmimit, si dokumente të dorëzuara dhe të pranishme në dosjen e tenderit në fjalë, janë autentike dhe janë vendosur nga z. Fatbardh MUHARREMI, lindur më datë 02.11.1978, në Prishtinë, n. personal 1004811905, me dorën e tij;

Z. Fatbardh MUHARREMI, me të dhënat anagrafike si më lart, është person i autorizuar nga z. Lum MUHARREMI, Drejtor menaxhues dhe përfaqësues i autorizuar i kompanisë EX FIS SHPK, që të nënshkruajë, në emrin e z. Lum MUHARREMI, dokumentet e ndryshme të dosjes së tenderit, pa asnjë kufizim në vëllim të autorizimeve, si dhe numër, përmbajtje, apo lloj të dokumentit;

Për pasojë, AK ka vërtetuar se Deklarata për afat të furnizimit/liferimit dhe Paramasa me përshkrim të çmimit, si dokumente të dorëzuara dhe të pranishme në dosjen e tenderit në tjalë janë autentike, të rregullta dhe të pranueshme, përkatësisht janë nënshkruar nga z. Fatbardh MUHARREMI, për dhe në emër të z. Lum MUHARREMI, si Drejtor menaxhues dhe përfaqësues i autorizuar i kompanisë EX FIS SHPK.

Mandati ligjor i z. Fatbardh MUHARREMI dhe zotësia/kapaciteti i tij formal për të nënshkruar dokumentet e dosjes së tenderit për dhe në emër të z. Lum MUHARREMI, si Drejtor menaxhues dhe përfaqësues i autorizuar i kompanisë EX FIS SHPK, buron shprehimisht nga pikat 7, 13, 17, 19 dhe 21 të Autorizimit të përgjithshëm për përfaqësim, LRP. Nr. 0246/2022, dhënë më datë 14.01.2022, në zyrën e noteres Leartë Cana, që i është bashkëngjitur përgjigjes së OE EX FIS SHPK, dt. 16.09.2024. AK ka vërtetuar se dokumenti në fjalë është prodhuar përpara njoftimit për tender dhe hapjes së ofertave në tenderin në fjalë.

Në po të njëjtën mënyrë, AK ka vërtetuar se Autorizimi dt. 11.08.2022-i përmendur në vendimin OSHP. Nr. 2024/0513, dt. 19.08.2024, si dhe autorizimi dt. 27.06.2024 janë nënshkruar nga z. Fatbardh MUHARREMI, lindur më datë 02.11.1978, në Prishtinë, n. personal 1004811905, me dorën e tij.

Edhe në këtë rast, AK ka vërtetuar se nënshkrimet kaligrafike të vendosura në autorizimin dt. 11.08.2022 dhe dt. 27.06.2024 janë autentike dhe janë vendosur me dorë nga z. Fatbardh MUHARREMI, me të dhënat anagrafike si më lart, bazuar në prokurën/aktin noterial LRP. Nr. 0246/2022, dt. 14.01.2022.

Si përfundim, me përgjigjen e OE EX FIS SHPK, dt. 16.09.2024 dhe dokumentet shoqëruese, AK ka vërtetuar se nënshkrimet kaligrafike të vendosura në Deklaratën për afat të furnizimit/liferimit, në Paramasën me përshkrim të çmimit, si dhe në autorizimet dt. 11.08.2022 dhe dt. 27.06.2024, si dokumente të dorëzuara dhe të pranishme në dosjen e tenderit lëndor, janë autentike dhe të gjitha janë të vendosura nga z. Fatbardh MUHARREMI, lindur më datë 02.11.1978, në Prishtinë, n. personal 1004811905, me dorën e tij.

AK vlerëson se në rivlerësim ka adresuar, analizuar dhe sqaruar të gjitha çështjet e ngritura nga OSHP në vendimin OSHP. Nr. 2024/0513, dt. 19.08.2024, si dhe që konform nenit 52.7 të LPP dhe nenit 38.3 të RRPP ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale të duhura në drejtim të

vërtetimit të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike, ndaj dhe pretendimi nr. 1 refuzohet si i pabazuar, për shkak të arsyeve të theksuara detajisht më lart.

2) Pretendimi i juaj për çmimin jo normalisht i ulët i Operatorit Ekonomik “Exfis”, nuk qëndron me faktin se Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit të tenderëve ka bërë edhe ekzaminimin e çmimeve të të gjithë Operatorëve Konkurrues lidhur me këtë tender.

Më poshtë do t ju paraqesim me fakte se si është bërë krahasimi për çmimin jo normalisht t të ulët:

Mostër merret çmimi i O.E. Patroni dhe O.E. Lab Oil: $6.527.456,96 \text{ €} + 6.635.765,38 \text{ €} = 13.163.222,34 \text{ €}$ $13.163.222,34 / 2 = 6.581.611,17 \text{ €}$ çmimi mesatar $6.581.611,17 \text{ €} / 6.381.572,14 \text{ €}$ (Çmimi i Exfis) = 0.3 % që do të thotë, që çmimi është nën kufirin e lejueshëm prej 30% dhe nuk mund të llogaritet si çmim jo normalisht i ulët.

Gjithashtu sa i përket edhe Primit, mostër merret Primi i O.E. Patroni dhe O.E. Lab Oil: $29,00 + 93,20 = 122,20 \text{ €}$ Patroni, $52,00 + 80,00 = 132,00 \text{ €}$ Lab Oil $122,20 + 132,00 = 254,20 / 2 = 127,10 \text{ €}$ çmimi mesatar $57,00 + 52,00 = 109 \text{ €}$ (Primi Exfis) $127,10 / 109,00 = 14.24 \%$ që do të thotë, që çmimi është nën kufirin e lejueshëm prej 30% dhe nuk mund të llogaritet si çmim jo normalisht i ulët. Në bazë të gjithë argumenteve të cekura më lartë Autoriteti Kontraktues KEK sh.a. vie në konkludim që kërkesa e juaj për rishqyrtim të Refuzohet.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 16.10.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0970/2024, ndërsa me datë 27.10.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/0970 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së. (2024/513).

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, “Autoriteti kontraktues nuk pajtohet me raportin e ekspertizës . Ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues ”

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për te vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “PATRONI” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0970 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr.1 Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimet e OE ankues ne këtë aktivitet te prokurimit janë te njëjta me ato ne baze te te cilave është marre vendimi i PSH me nr. 2024/513.

I. Përmbledhje e Procedurës dhe Pretendimeve Ankimore Gjatë shqyrtimit të ankesës së parë të Operatorit Ekonomik (OE) ankues, janë paraqitur dy pretendime kryesore që kanë të bëjnë me:

Nënshkrimet në dokumentet e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë. Çmimi i ofertuar nga ky OE.

Paneli Shqyrtues (PSH) ka kryer një vlerësim mbi këto pretendime dhe ka nxjerrë vendimin 2024/513. Sipas këtij vendimi, është konfirmuar se nënshkrimet e prezantuara në dokumentet e OE-së të rekomanduar për kontratë nuk janë identike dhe ndryshojnë në dokumente të ndryshme brenda ofertës së paraqitur. Po ashtu, as (AK) nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të dëshmuar se këto nënshkrime janë nga i njëjti person.

II. Veprimet Pas Vendimit 2024/513

Pas rikthimit të lëndës në rishqyrtim më datë 13.09.2024, AK ka dërguar kërkesë për sqarim pranë OE-së të rekomanduar për kontratë. Me anë të shkresës së datës 16.09.2024, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një përgjigje, duke bashkangjitur edhe një autorizim të noterizuar me nr. 0246/2022, që është i njëjti dokument i dorëzuar më parë (2024/513) gjatë procedurës së ankimimit.

III. Vlerësimi i Ekspertit Shqyrtues

Eksperti shqyrtues ka analizuar dokumentacionin e ri të dorëzuar dhe ka konstatuar si më poshtë:

OE i rekomanduar për kontratë, pavarësisht mundësisë së ofruar për të sqaruar dhe për të mbështetur pretendimet e tij me dokumente të reja ose prova shtesë, nuk ka ofruar asnjë dëshmi të re në përgjigjen e tij. Dokumentet e paraqitura janë të njëjta me ato të trajtuara gjatë ankesës së mëparshme, të cilat tashmë kanë qenë subjekt i një vendimi nga PSH.

AK, në vendimin e saj në kërkesën për rishqyrtim ndaj OE ankues, ka përdorur tekst të ngjashëm me arsyetimin e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, duke mos ofruar asnjë provë të re ose argument të qëndrueshëm për të mbështetur vendimin e saj.

Për më tepër gjatë argumentimit PSH ka dëshmuar edhe papërgjegjshmërinë e OE te rekomanduar për kontratë, por edhe përkundër kësaj AK dhe OE ankues prape kanë dështuar ta argumentojnë përgjegjshmërinë e OE te rekomanduar për kontratë.

IV. Përfundimi i Ekspertit Shqyrtues

Eksperti shqyrtues, duke pasur parasysh të gjitha faktet e sipërpërmendura, vlerëson se:

Pavarësisht aplikimit të nenit 52.7 të Ligjit për Prokurimin Publik nga AK, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë asnjë argument ose dëshmi shtesë.

Duke marrë në konsideratë rishikimin e çështjes në tërësi dhe faktin se pretendimet ankimore të OE-së janë trajtuar dhe janë vendosur më parë, eksperti shqyrtues vlerëson se këto pretendime duhet të konsiderohen si çështje të gjykuara “res judicata”.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e ekspertit dhe konstaton se lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Po ashtu neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së sqaron: “Në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i Panelit Shqyrtues i trajton si çështje të gjykuara “res judicata”. Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, edhe eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të trajtohet si çështje të gjykuar “res judicata”

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.2024/0513, dihet mirë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.

Paneli vlerëson se Autoriteti Kontraktues - “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a, zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe komisioni i ri-vlerësimit gjate vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk e ka marr për bazë fare Vendimin e OSHP- së nr. 2024/0513 të datës 19.08.2024, ku në bazë të këtij vendimi konkretisht në faqen 10, PSH konstaton se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe AK të veproj konform nenit 52.7 të LPP. Rrjedhimisht, AK pasi që ka kthyer lëndën në ri-vlerësim, prapë e shpallë OE e e njëjtë të rekomanduar për kontratë që sipas vendimit të OSHP i cila ka marrur formën e prerë është i papërgjegjshëm. Me këtë rast AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 97 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ku sipas këtij neni tek pika h), Mos respektimi i vendime të OSHP, konsiderohet shkelje e rëndë në Prokurimin Publik.

Andaj, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues (AK) “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a, që në tërësi të zbatohet vendimi i PSH nr. 2024/0513. OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a, që të ndërmarr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të

LPP-së dhe njëkohësisht do të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a, në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 56.3, 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- **OE - PATRONI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: